

RRETH PROJEKTIT

Pas përvojës dhe jehonës së dy viteve të kaluara, edhe këtë vit Turneu Kulturor do të organizohet në kuadër të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë dhe Javës së Mobilitetit Evropian, ku START-i i saj do të shënohet nga 'Lidhja e Prizrenit' në Prizren. Krahas këtij aktiviteti jo-garues dhe rekreativ të çiklizmit, në Prizren do të festohet në mënyra të ndryshme duke përfshirë edhe surprizat e rastit!

KUSHTET E PJESËMARRJES

- * STARTI – Turneu do të startojë nga Lidhja e Prizrenit duke përshkuar rrugën nëpër Shadërvan për të vazhduar rrugëtimin drejt Mamushës dhe Hoçës së Madhe. FINISHI do të shënohet në fabrikën e verës 'Stone Castle' në Rahovec.
- * Turneu përfshinë afërsisht 43 km dhe është lehtë i përshkrueshëm për të gjitha grupmoshat dhe gjinitë, pasi është aktivitet jo-garues.
- * Transporti për në Prizren ku do të bëhet nisja është i siguar nga organizatorët. Nisja e autobusëve do të bëhet prej disa qyteteve të Kosovës, si: Prishtinë, Pejë, Gjakovë e Ferizaj. Nisja bëhet prej stacionit të autobusëve të secilit qytet, në ora 8:00 në mëngjes. Kthimi nga Rahoveci, si stacioni i fundit i turneut, për në vend-nisjet fillestare bëhet në fund të turneut.
- * Kushdo që nuk posedon biçikletë personale do të ketë mundësinë e marrjes me qera me një shumë simbolike prej €10.
- * Ambulanca në funksion të personave në nevojë, mekaniku i bicikletave dhe një kamionetë për ndihmë do të na shoqërojë përgjatë gjithë turneut.
- * Gjatë turneut do të servoheni me pemë dhe perime, për të marrë një 'koktej' vitaminash.
- * Në çdo vend-ndalje të parashikuar me agjendë do të shërbeheni me ujë të pijes.
- * Ushqimi, pijet jo-alkoolike dhe vera janë të siguar për të gjithë pjesëmarrësit.
- * Rruga përshkohet në ritëm individual, me mundësinë të futet në turne apo ta lë atë në çdo kohë.
- * Në rast se ndiheni të lodhur dhe nuk mund të vazhdoni tutje, në dispozicionin tuaj keni një makinë mobile e cila do të ju dërgojë në vend-ndaljen e radhës.
- * Përpos ofrimit të ndihmës së shpejtë në rast nevojë, organizatorët nuk marrin përgjegjësi për sigurimin e përgjithshëm shëndetësor.
- * Pra, pjesëmarrja juaj është në llogarinë tuaj. JU duhet të llogaritni në paisjet, shëndetin dhe logjistikën tuaj në çdo kohë!
- * Për çdo paqartësi dhe informatë shtesë para dhe gjatë turneut mund të kontaktoni përmes:

Email: culturetour@unhabitat-kosovo.org

Mob: 044 185 618 & 049 372 639